

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 9299 Rep.
NR. 2958 Kol.



**KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS
“BOT” PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“MESHANIK” DHE “GUVË”**

BAZUAR NË VKM NR. 448, DATË 16.06.2010 DHE KONTRATËN E KONCESIONIT

Në Tiranë, më datë 31. muaji Korrik, viti 2013 (dymije e trembedhjetë), para meje noter _____, anëtar i dhomës së Noterisë TIRANË, me adresë _____, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga z. Florjon MIMA, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga _____

DHE

Shoqëria koncesionare “Gusmari” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR datë 11.08.2009 dhe me NIPT K99411501E, përfaqësuar nga z. Siri Sinani, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. _____

Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së koncesionit të formës BOT, të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “Drini 2000”, “Jundrit” dhe “Boka AXH” Sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Meshanik” dhe “Guvë”, hyrë në fuqi dt. 14.07.2009.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

Në VKM nr. 448, datë 16.06.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 27, datë 19.01.2007, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij" është parashikuar se "...Autoriteti Kontraktor, në bazë të një vlerësimi, mund të japë një afat deri në 12 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet deri në 5 MW, deri 18 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet nga 5 deri 20 MW dhe deri në 24 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion mbi 20 MW, për marrje lejeje dhe përgatitje projekti" dhe "...Të gjitha shoqëritë koncesionare, të cilat, deri në hyrjen të fuqi të këtij vendimi, nuk e kanë parashikuar afatin e nevojshëm të marrjes së këtyre lejeve në kontratat koncesionare përkatëse, kanë të drejtë ta shtyjnë afatin.....

.... Shtyrja e afatit të pasqyrohet, për çdo rast, në kontratat shtesë të palëve në koncesion. Ministri përgjegjës i miraton këto kontrata, të cilat hyjnë në fuqi me firmosjen e saj nga palët."

- Duke qënë se në nenin 10 "Programi i punimeve" të kontratës së koncesionit nuk është parashikuar koha për marrjen e lejeve, Konçesionari plotëson kushtet e parashikuara nga VKM nr. 448, datë 16.06.2010 për të përfituar nga zgjatja e afatit për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve.

Referuar Pikës 6 (a), të Udhëzimit Nr.873, datë 13.12.2010 "Për përcaktimin e kriterëve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara", koncesionari ka të drejtë të përfitojë 12 muaj shtesë afati për vënien në shfrytëzim të hidrocentraleve.

- Neni 10, pika 3, e Kontratës së Konçesionit parashikon se afati për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve mund të zgjatet në marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre;
- Palët njohin dhe pranojnë se Konçesionarit/shoqërisë koncesionare i janë shkaktuar vonesa nga autoritetet dhe institucionet e ndryshme shtetërore në marrjen e lejeve të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve "Meshanik" dhe "Guvë", përtej kohës së rregullt procedurale, siç parashikohet në nenin 10, pika 3, të Kontratës së Konçesionit;

Në Kontratën e koncesionit të formës BOT, për ndërtimin e hidrocentraleve "Meshanik" dhe "Guvë", nënshkruar dhe hyrë në fuqi datë 14.07.2009, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10, "Programi i punimeve":

Pika 2, zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

"Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralet brenda 66 (gjashtëdhjetëgjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit. Afati i ndërtimit është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur."

Neni 2

Kjo kontratë shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata shtesë e koncesionit u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi u lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe une noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga:

Z. FLORJON MIMA

SHOQËRIA KONÇESIONARE

"Gusmari" Sh.p.k

Përfaqësuar nga:

Z. SIRI SINANI

JULIAN ZHELËGU

